



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 46

Prishtinë, më 11.12.2018, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Sami Kurteshi, Frashër Krasniqi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Bilall Sherifi dhe Shkumbin Demaliaj.

Mungoi: Jelena Bontiq

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Egzon Murturi, KDI; Shqipe Pajaziti, Kosova Press; Fitore Sopjani, Infokusi; Erëblinë Ajazi, Kuvendi; Shaban Murturi dhe Blerta Bejtullahu, EUSR/EUO; Sanije Berisha, OSBE; Rreze Hoxha, GLPS; Granit Osa, praktikant; Besjana Bajrami, EO; Kaltrina Ajvazi, IKD; Blendon Arifi, Edison Sylja dhe Bekim Ibishi, praktikant, UP.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

Nga stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Fatbardha Boletini dhe Mirlinda Kolgeci.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtur më datë 16 dhe 23.10.2018;
3. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të institucioneve/agjencive që bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion për vitin 2019;
4. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës, me kandidatët për drejtor dhe zëvendës drejtor të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë për Verifikim dhe Krahasim të Pronës;

5. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore për Projektligjin nr. 06/L-056 të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
6. Shqyrtimi i kërkesës së NPN "HOXHA", lidhur me interpretimin e dispozitës ligjore të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për ndërtim;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Pas diskutimeve për të futur në rend dite shqyrtimin e raportit për Projektligjin nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, kryetarja konstatoi se anëtarët e komisionit morën këtë vendim që me 4 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim, propozimi i z. Beqaj miratohet për t'u futur në rend dite kjo pikë e rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua me ndryshime, duke u futur në rend të ditës shqyrtimi i raportit për Projektligjin nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me 4 vota për dhe 3 abstenime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë 16 dhe 23.10.2018

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më datë 16 dhe 23.10.2018, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të institucioneve/agjencive që bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion për vitin 2019

Kryetarja paraqiti për shqyrtim kërkesat buxhetore të institucioneve/agjencive që bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion dhe tha se kam qenë në Komisionin për Buxhet dhe Financa, kur është shqyrtuar në parim projektbuxheti për vitin 2019, duke pohuar se e ka analizuar buxhetin dhe sidomos në atë që ndërlidhet me institucionet në fushën e drejtësisë dhe që bien në fushëveprim të komisionit. Më tej, shtoi se ka shprehur shqetësim për disa prej institucioneve për mosndarje të mjeteve, ndërkohë që i janë shtuar kompetencat, prandaj ua dha fjalën përfaqësuesve të institucioneve, në lidhje me kërkesat e tyre buxhetore.

Enis Halimi, tha se kërkesat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kanë të bëjnë me çështjet buxhetore për stafin, duke pohuar se janë më poshtë me pagesë kundrejt institucioneve tjera që kanë bazë të njëjtë kushtetuese, siç është Këshilli i Pavarur i Mediave, Avokati i Popullit etj. Gjithashtu, kërkesa tjetër është logjistike, sepse KQZ-ja funksionon në ish-ndërtesën e Bankës së Lubjanës, në katin e parë, e cila nuk është e përshtatshme dhe për më tepër kur volumi i punëve në kohën e zgjedhjeve është edhe më i madh dhe që stafi shumëfishohet. Më tej, shtoi se kanë diskutuar edhe me Bashkimin Evropian, për një mbështetje eventuale në kuptim të IPA- fondeve, që të na fusin në IPA 2019, për të vazhduar edhe viteve vijuese me 1 milion e gjysmë euro. Pra, kërkesa e tyre fillestare ka qenë për ndërtimin e Qendrës së Numërimit dhe të Rezultateve, në mënyrë që të funksionalizohet më mirë kjo qendër, ndërsa kjo kërkesë ka pësuar një metamorfozë dhe tashmë janë stadin që me Bashkimin Evropian janë pajtuar që të financojnë vetëm për objektin e KQZ-së, andaj kërkuan që donacionit 1 milion e gjysmë euro, t'i ndahet edhe 1 milion nga Qeveria, për kompletuar ndërtimin e objektit në tërësi.

Blerim Isufaj, kryesues i KPK-së, tha se përmes kërkesës për buxhetin ka kërkuar 18,305,492 euro, që kryesisht janë për paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale dhe shpenzime kapitale, ndërsa buxhet për vitin 2019 është ndarë 14,170,065 euro, ku shumica prej tyre janë paga dhe mëditje për 846 pozita, sa ka gjithsej KPK. Në kategorinë e pagave dhe mëditjeve janë paraparë edhe 10 prokurorë shtesë, 5 prokurorë në Prokurorinë Speciale dhe 5 prokurorë për prokuroritë tjera, po ashtu edhe 136 bashkëpunëtorë profesionalë, që janë paraparë në ligjin për ndryshim-plotësimi e Ligjit për Prokurorinë e Shtetit. Gjithashtu, kanë paraparë 14 përkthyes shqip-anglisht, kur dihet se integrimi i minoritetit serb në pjesën veriore ka bërë që shumë lëndë dhe materiale duhet të përkthehen, ndërkaq kanë kërkuar 8 ekspertë në ofrimin e ekspertizave të ndryshme jo vetëm në lëmin profesionale të juristit, por që kanë të bëjnë në lëmin e pastrimit të parasë, kontabilitetit, korrupsionit, krimeve kibernetike. Në kategorinë mallra dhe shërbime, ku kryesisht kërkesa e tyre ka qenë për shpenzimet e avokatëve dhe ekspertëve, në të cilën borxhet e kanë përcjellë kohë pas kohe, mirëmbajtja e pajisjeve dhe objekteve, përfundimi i objektit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë etj. Më tej, z. Isufaj shtoi se kanë paraparë edhe çështjen e sigurimit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, që për fat të keq nuk është nivel të duhur, andaj kemi paraparë që ne duhet të rekrutojmë sigurimin tonë, me qëllim që të menaxhojmë objektin. Po ashtu, kemi edhe sistemin menaxhimit të lëndëve- SMIL, i cili është njëri ndër projektet më me rëndësi për Këshillin i financuar nga Qeveria e Norvegjisë, na obligon të sigurojmë 3 zyrtarë të teknologjisë informative, me përgjegjësi specifike në organizimin e SMIL-it. Në fund, tha se kemi kërkuar që të ndahet buxhet për një pozitë mbikëqyrës të mbrojtjes së viktimave dhe një koordinator të mbrojtësve të viktimave për vitin 2019.

Nehat Idrizi, kryesues i KGJK-së, tha se kërkesat shtesë të KGJK-së, sipas qarkores buxhetore 2019/01 për kategorinë paga dhe mëditje është 18,027,657.00 euro, ndërsa sipas qarkores 2019/02 shuma për kategorinë paga dhe mëditje është 22,288,779 euro, për 2271 pozita, prandaj duhet të bëhet korrigjimi i kufijve buxhetorë te kategoria e pagave dhe mëditjeve për 4,119,800.86 euro. Sipas koncept-dokumentit gjatë hartimit të projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, kostoja buxhetore shtesë për një vit në kategorinë e pagave dhe mëditjeve është gjithsej 293.297.10 euro, për 28 pozita. Po ashtu, është paraparë në Ligjin për ndërmjetësim, që në secilën gjykatë themelore të punësohet nga një zyrtar për ndërmjetësim, ku kostoja buxhetore shtesë për një vit në kategorinë paga dhe mëditje për këta zyrtarë është gjithsej 51,830.10 euro, për shtatë pozita. Projektligji për gjykata parasheh që për çdo gjyqtar të ketë një bashkëpunëtor profesional, ku kostoja buxhetore shtesë është për një vit në kategorinë paga dhe mëditje, gjithsej është 725,928.00 euro, për 80 pozita. Në mënyrë që të arrihen objektivat strategjike të KGJK-së për ngritje të efikasitetit të punës nëpër gjykata në zgjidhjen e sa më shumë lëndëve gjyqësore, KGJK ka parashtruar kërkesë për 5 pozita të reja për gjyqtarë në Gjykatën e Apelit, si dhe 25 pozita të reja për gjyqtarë në gjykatat themelore të Kosovës, ku kostoja buxhetore në kategorinë e pagave dhe mëditjeve për këta gjyqtarë është gjithsej 906,815.25 euro, për 30 pozita. Në bazë të kërkesave për pozita shtesë nga gjykatat, që të punësojnë disa kategori të personelit për mbështetje ligjore, kërkesë kjo e bazuar edhe në qëllimin e theksuar në qarkoren buxhetore 2019/01, ku thuhet se kërkesat buxhetore duhet të jenë në përputhje me prioritetet politike të Qeverisë e që një ndër to është edhe sundimi i ligjit. Në funksion të kësaj është edhe punësimi shtesë i zyrtarëve ligjorë në gjykata dhe pozita tjera administrative, ku kostoja buxhetore shtesë për një vit në kategorinë e pagave dhe mëditjeve për këta zyrtarë është gjithsej 417,610.14 euro, për 53 pozita. Kërkesa

buxhetore shtesë mbi kufijtë buxhetorë, të parapara me qarkoren buxhetore 2019/02 për të gjitha kategoritë ekonomike për vitin 2019, për Këshillin Gjyqësor të Kosovës është 6,805,280.59 euro.

Florijs Kika, Agjencia për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, tha se ka parashtruar në Ministrinë e Financave kërkesën buxhetore për vitin 2019, në vlerë prej 3,993,214 euro dhe nga kjo kërkesë buxhetore, ministria ka ndarë 2,990,706 euro, që d.m.th. rreth 1 milion euro më pak se kërkesa e parashtruar nga agjencia. Në gjitha kategoritë ekonomike ka përjashtim të mjeteve buxhetore, përveç kategorisë së komunalit. Më tej, znj. Kika theksoi se sa i përket financimit të skemës së kompensimit janë ndarë këtë vit 600 mijë euro dhe pritet që në bazë të kornizës afatmesme, që edhe në vitin 2020 të ndahen edhe 600 mijë euro tjera.

Shkumbin Demaliaj, tha se mundësisht të na tregoni se cilat nga kërkesat e juaja nuk janë përkrahur, njëvjeçare dhe jo afatgjate, në mënyrë që ne, si komision, t'i përkrahim amendamentet e propozuara nga komisioni.

Kryetarja, tha se do të formojnë një grup të punës, në lidhje me kërkesat buxhetore të institucioneve/agjencive që bien në fushëveprim të komisionit, për t'i analizuar secilin veç e veç, duke u fokusuar tek ato kërkesa që kanë prioritet më të lartë dhe do të kërkojnë nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, përmes amendamenteve, që të përkrahen kërkesat buxhetore.

Sami Kurteshi, pyeti: si ka mundësi që ka kaq dallim në pagë në mes gjyqtarit/prokurorit dhe bashkëpunëtorit profesional, ndërkohë që bashkëpunëtori profesional punon njëjtë si me gjyqtarin dhe prokurorin?

Blerim Isufaj, sqaroi se bashkëpunëtorët profesionalë rekrutohen në bazë të Ligjit për shërbim civil, prandaj është ky dallim në pagë.

Kryetarja, tha se bashkëpunëtorët profesionalë bëjnë një punë jashtëzakonshme dhe paguhen pak, andaj në Projektligjin për paga kemi propozuar amendamente, që koeficienti për bashkëpunëtor të përfshihet në ligjin për paga, por edhe që t'iu rritet koeficienti dhe nuk asnjë arsye të kundërshtohet.

Sami Kurteshi, tha se ka për të qenë problem që një jurist i mirë të punojë për atë pagë si bashkëpunëtor profesional.

Blerim Isufaj, tha se kemi kërkuar që administrata e sistemit prokurorial të ketë statusin e veçantë, duke e argumentuar se përse duhet të ketë status.

Hajdar Beqa, tha se pajtohem të gjithë se bashkëpunëtorët profesionalë, si në prokurori edhe në gjykatë, kanë vëllim të madh të punëve, prandaj kërkoi që Lëvizja Vetëvendosje, krahas amendamentit të propozuar nga vetë kjo parti, të përkrahë edhe Projektligjin për paga, në tërësi, kur të jetë në rend dite të seancës plenare.

Kryetarja pyeti: a do të ketë shtesa për gjyqtarët që do jenë në departamentin special, në kuadër të gjykatës themelore, sikurse për prokurorët specialë?

Nehat Idrizi, tha se edhe gjyqtarët që do të punojnë në këtë departament duhet të kenë trajtim të veçantë, sikurse e kanë prokurorët specialë, sepse do jetë vështirë që ata të punojnë me vullnetin e duhur.

Ardian Bajraktari, përfaqësues i MD-së, tha se në emër të Ministrisë së Drejtësisë njoftoi se nuk kanë kërkesa shtesë, për faktin se kanë pasur një diskutim jashtëzakonisht të mirë me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe kërkesat e Ministrisë së Drejtësisë, duke përfshirë edhe agjencitë që funksionojnë në nivel të ministrisë, janë përfshirë në projektbuxhetin e vitit 2019.

Alajdin Ibrahim, përfaqësues nga ANJF, kërkoi aktivizimin e klinikës mobile, ku do të ofrohet ndihma juridike falas nëpër komuna të Kosovës, ku nuk ka zyrtarë për ndihmë juridike falas dhe gjeografikisht janë të largëta. Po ashtu, tha se sipas një analize nga agjencia, 60% e qytetarëve i plotësojnë kriteret për të kërkuar ndihmë juridike falas.

Sami Kurteshi, tha se kjo është agjencia më e rëndësishme, sepse ka të bëjë me një kategori të njerëzve që kanë shumë nevojë, por kanë shumë pak mundësi. Këtu shihet qasja e shtetit ndaj të dobët dhe të varfrit, andaj e përkrah këtë agjenci, duku u rritur edhe numri i stafit që punojnë aty.

Bilall Sherifi, tha se kjo është një temat shumë të rëndësishme, që duhet të këmbëngulet për t'i rritur kapacitet e kësaj agjencie, sepse nuk ka pozitë më të vështirë kur njeriu përballet me situata të vështira.

Valon Kurtaj, drejtor i Akademisë së Drejtësisë, tha se nga kërkesa buxhetore e kërkuar, 76% është miratuar dhe janë futur në projektbuxhetin e vitit 2019, ndërsa 24% nuk është miratuar. Pra, nga të gjitha kategoritë ekonomike ka mangësi të buxhetit, përveç kategorisë ekonomike, komunal, e cila është miratuar në tërësi. Vlen të theksohet se në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale, se në shumën 550 mijë euro është miratuar kërkesa për ndërtimin e objektit të Akademisë së Drejtësisë, kërkesë kjo e kahershme dhe shumë e rëndësishme për Akademinë e Drejtësisë. Më tej, z. Kurtaj tha se në kategorinë ekonomike, mallra dhe shërbime, Akademia e Drejtësisë ka nevojë të plotësohet, sepse tanimë është shtuar edhe programi kalendarik për trajnime të detyrueshme për gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët nëse nuk e ndjekin, mund të marrin edhe masa të menjëhershme ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, për mospërbushje të këtij kriteri.

Kryetarja, duke kaluar te përfaqësuesi i Agjencisë Kundër Korrupsionit, tha se kësaj agjencie i janë dhënë edhe kompetenca shtesë, sipas Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve, por në anën tjetër, nuk është reflektuar me buxhet. Po ashtu, tha se zyrtarëve të kësaj agjencie, shtesat që ata i marrin momentalisht në emër të rrezikshmërisë në Projektligjin për pagat, ato janë hequr, duke pohuar se ky projektligj nuk duhet përkrahur. Më tej, ia dha fjalën përfaqësuesit të kësaj agjencie.

Bedri Misini, përfaqësues i Agjencisë Kundër Korrupsionit, tha se është e nevojshme që të përkrahet Agjencia Kundër Korrupsionit, në shumën totale prej 58,600.00 €, në kategorinë ekonomike, paga dhe mëditje, paga për 7 pozita shtesë, një pozitë me koeficient 10, me shumë 10,000.00 €, 2 pozita me koeficient 9, me shumë 17,400.00 dhe 4 pozita me koeficient 8, me shumë 31,200.00 €. Kjo për faktin se Agjencisë Kundër Korrupsionit i janë zgjeruar kompetencat dhe dukshëm i janë rritur përgjegjësitë, me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 06/L-011 për parandalimin

e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Po ashtu, zgjerimi i kompetencave dhe rritja e përgjegjësisë të agjencisë, priten me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve.

Sami Kurteshi, pyeti: a ka konflikt interesi Akademia e Drejtësisë po të vendosen në njërin prej institucioneve të drejtësisë, meqenëse Akademia e Drejtësisë është me objekt me qira?

Valon Kurtaj, u përgjigj se nëse Akademia e Drejtësisë vendoset në njërin prej institucioneve të gjyqësisë, por nëse Akademia e Drejtësisë vendoset në një institucion administrativ, sigurisht që mund të ketë konflikt interesi.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, nxori këtë:

V e n d i m

për formimin e grupit të punës për shqyrtimin e kërkesave buxhetore të institucioneve/ agjencie që bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion

1. Formohet grupi i punës për shqyrtimin e kërkesave buxhetore, në përbërje:

Hajdar Beqa- kryesues,
Korab Sejdiu-anëtar dhe
Sami Kurteshi-anëtar.

4. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës, me kandidatët për drejtor dhe zëvendës/drejtor të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë për Verifikim dhe Krahasim të Pronës

Kryetarja paraqiti për shqyrtim propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës, me kandidatët për drejtor dhe zëvendës/drejtor të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë për Verifikim dhe Krahasim të Pronës dhe tha se kandidatët për drejtor që i ka propozuar Qeveria, janë Naser Shala dhe Florije Kika, të cilët Kuvendi njëherë i ka përjashtuar për zëvendës-drejtor dhe janë propozuar Albina Maloku dhe Milaim Çekaj. Po ashtu, tha se jemi të obliguar që t'i procedojmë me ose pa përkrahje në Kuvend, duke shtuar se në bazë të marrëveshjes me Ambasadën e Britanisë për monitorimin e konkurseve dhe proceseve të tilla dhe Ambasada e Britanisë i ka vlerësuar me pikë më lart, se kandidatja Florije Kika i plotëson kushtet për të qenë drejtore e këtij institucioni, ndërsa Naser Shala nuk i plotëson kushtet për të qenë drejtor i këtij institucioni. Ndërkohë, Qeveria ka vlerësuar me pikë më lart z. Naser Shala, duke pohuar se kjo marrëveshje me Ambasadën e Britanisë nuk po respektohet fare as me APK-në, PTK-në, as me KEK-un, duke mbetur një marrëveshje vetëm në letër.

Hajdar Beqa, kërkoi që propozimit e Qeverisë me kandidatët për drejtor dhe zëvendës/drejtor të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë për Verifikim dhe Krahasim të Pronës, të procedohet për Kuvend, sepse si institucion është e domosdoshme që mos të mbetet me ushtrues detyre, pa paragjykuar se kush zgjidhet. Në të njëjtën frymë ishte edhe deputeti Shkumbin Demaliaj.

Kjo pikë e rendit të ditës, për mungesë të kuorumit, shtyhet për mbledhjen e radhës në komision.

5. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore për Projektligjin nr. 06/L-056 të Këshillit Prokurorial të Kosovës

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin e komisioneve kryesore për Projektligjin nr. 06/L-056 të Këshillit Prokurorial dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Kryetarja konstatoi se komisioni, me 5 vota për, 1 abstenim, e procedoi për Kuvend Projektligjin nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me rekomandimin e propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Amendamenti 1

Neni 11, paragrafi 2, në fillim të nënparagrafit 2.5, teksti: “ I propozon Kuvendit buxhetin e hartuar nga Këshilli”, ndryshohet me tekstin: “procedon buxhetin e hartuar nga Këshilli”.

6. Shqyrtimi i shkresës së NPN “ HOXHA”, lidhur me interpretimin e dispozitës ligjore të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për ndërtim

Kryetarja paraqiti për shqyrtim shkresën e NPN “HOXHA”, lidhur me interpretimin e dispozitës ligjore të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për ndërtim dhe tha se çfarë do lloj shkrese që vjen në komision, ne do ta trajtojmë dhe të japim përgjigje me shkrim, sepse duhet të krijojmë një rregull, që kur dikush na shkruan, ne duhet t’i përgjigjemi.

Hajdar Beqa, tha se shkresave të tilla është mirë që t’u kthehet përgjigje edhe pa ardhur u trajtuar në mbledhje të komisionit, nëse vlerësohet si e tillë.

Meqë nuk pati diskutime, kryetarja konstatoi se komisioni vlerësoi:

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në lidhje me këtë shkresë, nuk është kompetent për të interpretuar legjislacion në fuqi, përfshirë edhe nenet përkatëse të Ligjit për ndërtim.

Njëkohësisht, Komision funksional, për trajtimin e Ligjit për ndërtim është Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor.

7. Të ndryshme

A. Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Projektligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Hajdar Beqa, tha se si grup i punës kemi punuar, ku ka qenë një angazhim maksimal i të gjithë anëtarëve, por edhe i grupeve të interesit që kanë marrë pjesë në takimet e grupeve të punës. Më tej, z. Beqa tha se tek amendamenti 4, propozimi i Grupit Parlamentar 6 + është inkorporuar te propozimi i Komisionit funksional. Në fund, kërkoi nga anëtarët e komisionit që ta përkrahin raportin me amendamente të Projektligjit nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Bahri Shabani, u deklarua se i tërheq amendamentet e propozuara nga Grupi Parlamentar 6+ në lidhje me këtë projektligj.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni, me 4 vota për dhe 2 abstenime, nxori këtë:

Rekomandim

I. Miratohet raporti me amendamente i komisionit;

II. Projektligjin nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim sipas kompetencës në komisionet kryesore;

III. Amendamentet e miratuara dhe të papërkrahura nga komisioni, janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali.

B. Propozim/njoftim

Hajdar Beqa, propozoi që të ftohen të gjithë ata që kanë marrë pjesë në punën dhe përcjelljen e punës së komisionit, në një koktej për fundvit, të shtruar në shenjë falënderimi.

Propozimi u përkrah nga të gjithë anëtarët e komisionit, për t'i ftuar mediat dhe shoqërinë civile që kanë përcjellë punën e komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 15:35.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Albulena Haxhiu

Aneks- Amendamentet e propozuara në Projektligjin nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;

Amendamenti 1

Në tërë tekstin e projektligjit fjalët “të saj/tij” ose “të tij/saj” hiqen dhe përshtatet sipas kontekstit të fjalisë.

Amendamenti 2

Neni 1 titulli riformulohet si vijon:

“Qëllimi”

Në nenin 1 në rreshtin e katërt fjala “Gjykatë” zëvendësohet me fjalën “Gjykatës” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 3

Neni 2, nënparagrafi 1.9, riformulohet si vijon: “1.9 **Person** - personi fizik, juridik, autoritet publik apo sipërmarrje.

Neni 2, nënparagrafi 1.15, pas fjalës “person juridik” shtohet fjala “biznes individual” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 2, nënparagrafi 1.18 fjala “apo” hiqet dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Në nenin 2, pas nënparagrafit 1.26, shtohet një nënparagraf i ri 1.27, me përmbajtjen si vijon: “1.27. **Kolegj i bashkuar** – kolegj i përbërë nga të gjithë gjyqtarët e Kolegjit të Apelit, i cili është kompetent për të përcaktuar qëndrimet parimore dhe mendimet juridike për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin unik të ligjeve apo njësimin e praktikës gjyqësore.”

Neni 2, paragrafi 2 riformulohet si vijon: “2. Fjalët e përdorura në cilëndo gjini në këtë ligj do të përfshijnë edhe gjininë tjetër.

Neni 2, paragrafi 4 riformulohet si vijon: “4. Që nga hyrja në fuqi e këtij ligji, secila referencë në legjislacion ndaj Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme dhe Shtojcës së tij, apo të ndonjë dispozite të caktuar të saj, do të nënkuptojë këtë ligj, respektivisht dispozitat analoge të këtij ligji.”

Amendamenti 4 dy propozime

A. Propozim i Komisionit FunkSIONAL

Në nenin 4, paragrafi 2, fjalët “ një (1)” zëvendësohen me “dy (2)” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

B. Propozim i grupit parlamentar Lista Serbe pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Ndryshohet paragrafi 2 i nenit 4 i projektligjit si vijon:

Dhoma e Posaçme në përbërjen e saj ka gjyqtarë të cilët janë shtetasë të Kosovës dhe shprehin përbërjen etnike të strukturës së popullsisë së Kosovës, më së paku 2 (dy) gjyqtarë nga radhët e komunitetit serb në Kosovë dhe së paku 1 (një) gjyqtar nga radhët e komuniteteve të tjera jo shumicë në Kosovë.

Amendamenti 5

Në nenin 4, paragrafi 7 riformulohet si vijon:

“7. Të gjithë gjyqtarët e emëruar në Dhomën e Posaçme duhet të përmbushin të gjitha kushtet e përcaktuara në Ligjin për Gjykatat dhe për gjyqtarët e Gjykatës Supreme. Me fokus të veçantë, gjyqtarët që shërbejnë në Dhomën e Posaçme duhet të kenë përvojë të dëshmuar në fushat në vijim:

7.1 të drejtat pronësore;

7.2 të drejtat e njeriut, me theks të veçantë në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

7.3 e drejta e punës dhe e falimentimit;

7.4 e drejta tregtare, përfshirë këtu qeverisjen e korporatave, dhe e drejta e detyrimeve;

Amendamenti 6

Neni 4, paragrafi 9, riformulohet si vijon: “9. Të gjitha lëndët për të cilat Dhoma e Posaçme ka kompetencë ekskluzive, siç është përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji, përveç kërkesave në lidhje me procesin e privatizimit dhe ato pronësore, shqyrtohen dhe gjykohen në shkallë të parë nga një gjyqtar i vetëm. Kërkesat në lidhje me procesin e privatizimit dhe kërkesat pronësore do të shqyrtohen dhe gjykohen në shkallë të parë nga një kolegji i specializuar, i përbërë nga tre gjyqtarë.

Amendamenti 7

Në nenin 4, paragrafi 10, në fillim të fjalisë, fjalët “Kolegji i Apelit” zëvendësohen me fjalët “Shkalla e dytë, Apeli,” si dhe në rreshtin e dytë, fshihet fjala “ të Apelit” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 4, paragrafi 13, fjala “kërkohet” përpara fjalës “nga gjyqtari mbikëqyrës” fshihet dhe fjala “e çmon” zëvendësohet me fjalën “e vlerëson”.

Amendamenti 8

Neni 5, nënparagrafi 1.10, riformulohet si vijon: “1.10. rasti apo procedura që del brenda fushëveprimit të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/48 apo legjislacionit pasardhës së saj, apo një ankesë apo procedurë që është në lidhje me një rast brenda fushëveprimit të kësaj rregullore apo legjislacionit pasardhës së tij”.

Në nenin 5, nënparagrafi 1.11, fjalët “këtë paragraf 1” zëvendësohen me fjalë “me paragrafin 1 të këtij neni.”

Neni 5, paragrafi 2, fshihet fjalia e dytë “Gjyqësor i Kosovës në Rregulloren për organizimin e brendshëm të gjykatave.

Neni 5, paragrafi 5, riformulohet si vijon: “Nëse Agjencia nuk është emëruar si palë në ndonjë lëndë që është në punë në ndonjë gjykatë sipas këtij paragrafi, gjykata në fjalë do të jetë e obliguar që emërojë Agjencinë si palë. Agjencia do të ketë të drejtën të marrë pjesë si palë *ex officio*, si dhe do të marrë kopjen e të gjitha shkresave të lëndës dhe do t’i dorëzohen të gjitha parashtesat në të ardhmen lidhur me lëndën apo procedurën.”

Në nenin 5, paragrafi 6, fjala “kufijte” zëvendësohet me fjalën “kufizimet” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 5, paragrafi 7, fjala “më lart” në fund të fjalisë së parë, zëvendësohet me fjalët “të këtij neni” dhe pas fjalëve “paragrafi 4:” në fund të fjalisë së dytë të paragrafit 7, shtohen fjalët “të këtij neni”.

Në nenin 5, nënparagrafi 7.1, fjala “e tillë” zëvendësohet me fjalën “tjetër” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 5, paragrafi 8 fjalët “Asnjë gjë” zëvendësohen me fjalët “Asgjë” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 9 Propozim i grupit parlamentar Lista Serbe pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Në nenin 4 të Projektligjit ndryshohet me shtimin e paragrafit 16 si vijon:

“ Në qoftë se është lëndë e procedurës gjyqësore ndërmarrja, korporata ose pasuria e cila gjendet apo është themeluar në komunat me shumicë serbe në Kosovë, në përbërjen e kolegjit të gjykatës së shkallës së parë nga paragrafi 9, ose të kolegjit ankimor nga paragrafi 10 i këtij neni detyrimisht duhet të jetë qoftë vetëm 1 (një) gjyqtar pjesëtar i nacionalitetit të komunitetit serb në Kosovë.”

Amendamenti 10

Neni 6, nënparagrafi 1.1.6. fshihet dhe renditja e nënparagrafit në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 11

Neni 8 i projektligjit riformulohet si vijon:

Neni 8 Paraqitja e provave

“Në çdo procedurë, gjyqtari i rastit apo kolegji i Dhomës së Posaçme mund të urdhërojë çdo person që të dorëzojë apo të afrojë prova, dëshmi, dokumente apo informacion përkatës, nëse gjyqtari apo kryesuesi i kolegjit përkatës me arsye beson se kanë rëndësi materiale apo janë relevante për procedurën”.

Amendamenti 12

Në nenin 9, fjala “Apelet” te titulli i nenit zëvendësohet me fjalën “Ankesat”, si dhe përgjatë të gjithë tekstit të këtij neni fjala “apel” zëvendësohet me fjalën “ankesë” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 9, paragrafi 2 në rreshtin e gjashtë pas fjalës “mospajtues” shtohet fjala “i nënshkruar” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 13 Propozim i grupit parlamentar Lista Serbe pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Fshihet paragrafi 5 i nenit 9 i Projektligjit, kështu që paragrafët e nenit 9 të Projektligjit 6,7,8,9,10,11,12,13,14 dhe 15 tani bëhen paragrafët 5,6,7,8,9,10,11,12,13 dhe 14.

Amendamenti 14

Neni 9, nënparagrafi 6 riformulohet si vijon: “6. Pala ka të drejtë të dorëzojë ankesë ndaj aktgjykimit apo aktvendimit të gjyqtarit të vetëm apo të kolegjit sipas paragrafit 9 të nenit 4 të këtij ligji, apo ndaj gjykatës që ka kompetencë mbi një lëndë sipas paragrafit 3 të nenit 5 të këtij ligji, duke parashtruar ankesën te kolegji i apelit dhe duke e dorëzuar atë ankesë te palët e tjera brenda pesëmbëdhjetë ditësh. Ankesa parashtrohet edhe para gjykatës apo gjyqtarit që ka nxjerrë aktvendimin apo aktgjykimin në fjalë, brenda të njëjtës periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh. Kolegji i apelit e hedh poshtë ankesën nëse pala dështon ta dorëzojë atë brenda periudhës së përcaktuar kohore.”

Në nenin 9, paragrafi 7 në rreshtin e dhjetë dhe katërbëdhjetë, fjalët "njëzet e një"(21) zëvendësohen me fjalët "pesëmbëdhjetë" (15) dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 9, paragrafi 8 në rreshtin e pestë, fjalët "njëzet e një" (21) zëvendësohen me fjalët "pesëmbëdhjetë" (15) dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 9, paragrafi 12 në rreshtin e dhjetë, fjala "dhjetë (10)" zëvendësohet me fjalën "tridhjetë (30)" dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 15 dy propozime

A. Propozim i Komisionit FunkSIONAL

Në nenin 10, paragrafi 2, fjalët "Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 04/L-033," fshihen dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 10, nënparagrafi 3.2 riformulohet si në vijim: "Ajo palë do të ketë të drejtë vetëm në kompensim adekuat monetar për humbjen e të drejtës, titullit apo interesit të tillë. Lartësia e një kompensimi të tillë do të përcaktohet nga një vlerësues i licencuar i paluajtshmerisë në bazë të vlerës së tregut për transaksionin në fjalë të kryer nga AKM-ja apo Agjencia, ndërsa shkalla e përmbushjes së atij kompensimi është subjekt i dispozitave në fuqi të Ligjit për AKP-në."

B. Propozim i grupit parlamentar Lista Serbe pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Në nenin 10 të Projektligjit fshihen paragrafët 2,3,4, dhe 5, kështu që paragrafët 6 dhe 7 bëhen 2 dhe 3.

Amendamenti 16

Neni 11 i projektligjit riformulohet si vijon:

Neni 11 Shpenzimet procedurale

Vendimi i lëshuar nga një gjyqtar i vetëm apo kolegji përcakton shpenzimet procedurale. Gjyqtari apo kolegji i gjyqtarëve në fjalë vendos për këto shpenzime sipas dispozitave përkatëse në Ligjin për Procedurën Kontestimore.

Amendamenti 17

Në kapitullin III, te titulli i kapitullit, fshihet përsëritja e fjalëve "GJYQTARËT E DHOMËS SË POSAÇME"

Amendamenti 18

Neni 13, titulli i nenit riformulohet si vijon:

Neni 13

Papajtueshmëritë dhe përjashtimi i gjyqtarëve

Neni 13, paragrafi 6, fjala “e veçantë” zëvendësohet me fjalën “e posaçme”.

Amendamenti 19

Në nenin 15 të projektligjit, fjala “regjistër-mbajtës” zëvendësohet me fjalën “zyrtar për menaxhimin e lëndëve” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 15, paragrafi 2 në rreshtin e dymbëdhjetë, fjala “e konfidenciale” fshihet dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 15, paragrafi 4 në rreshtin e katërt, fjala “kanal” zëvendësohet me fjalën “lidhje” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 15, paragrafi 7 fshihet.

Amendamenti 20

Neni 17 riformulohet si vijon:

Neni 17

Administrata nën udhëzimet e kryetarit të Gjykatës Supreme

Kryetari i Gjykatës Supreme, me ndihmën e Gjyqtarit Mbikëqyrës, do të udhëzojë administratën e Dhomës së Posaçme dhe, përveç nëse nuk parashikohet ndryshe me këtë ligj dhe punën e Dhomës së Posaçme.

Amendamenti 21

Neni 18, paragrafi 1, fjala “dy” fshihet dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 22

Neni 19, paragrafi 6, në fjalinë e parë, pas fjalës “Kryetari i Gjykatës” shtohet fjala “Supreme” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 19, paragrafi 6, fjala “të gjykatës” në fund të fjalisë së parë, zëvendësohet me fjalën “të Dhomës së Posaçme”.

Amendamenti 23

Neni 20, paragrafi 2 riformulohet si vijon: “2. Gjyqtari Mbikëqyrës zbaton rregullat dhe urdhëratë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe urdhëratë e Kryetarit të Gjykatës Supreme, të cilat i nxjerrin në pajtim me përgjegjësitë dhe kompetencat e tyre ligjore.”

Amendamenti 24

Neni 21 riformulohet si vijon:

Neni 21

Kompetencat dhe caktimi i lëndëve

1. Gjyqtari i vetëm është kompetent për të gjykuar në shkallë të parë për të gjitha kërkesat, ankesat apo lëndët e parashtruara pranë Dhomës së Posaçme si vijon:

1.1 Rastet që kanë të bëjnë me kërkesa apo ankesa në lidhje me të drejtat legjitime të punëtorëve sipas nenit 10 të Rregullores nr. 2003/13, apo legjislacionin pasardhës të saj, apo çështjet e përgjithshme të punësimit të një ndërmarrjeje apo korporate;

1.2 Rastet që kanë të bëjnë me ankesa apo çështje të tjera që dalin apo kanë lidhje me likuidimin e një ndërmarrjeje apo pasurive të saj;

1.3 Rastet që kanë të bëjnë me riorganizimin apo ristrukturimin e një ndërmarrjeje në bazë të Rregullores nr. 2005/48, Ligjit nr. 04/L-035 për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së tyre apo legjislacionit pasardhës të saj;

1.4 Raste të tjera që bien në juridiksionin e Dhomës së Posaçme siç është përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji.

2. Lëndët që kanë të bëjnë me kërkesa apo ankesa që dalin apo kanë lidhje me procesin e privatizimit të ndërmarrë nga AKM-ja apo Agjencia, si dhe rastet që kanë të bëjnë me kërkesa të përgjithshme të pronësisë do të gjykohen në shkallë të parë nga një kolegji prej tre gjyqtarësh, siç përcaktohet në paragrafin 9 të nenit 4 të këtij ligji. Përbërja e këtij kolegji do të caktohet nga Gjyqtari Mbikëqyrës.

3. Caktimi i lëndëve në shkallë të parë te gjyqtari i vetëm, gjegjësisht kolegji përkatës, bëhet përmes tërheqjes së shortit në pajtim me procedurat e përcaktuara në rregulloret e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Amendamenti 25

Neni 22, paragrafi 1, riformulohet si vijon: “1. Kompetencat e përcaktuara sipas këtij ligji për Dhomën e Posaçme apo gjyqtarët e saj janë kompetenca shtesë mbi ato që veçse janë të përcaktuara me ligje apo akte nënligjore të tjera në fuqi.”

Në nenin 22, nënparagrafi 2.3, fjala “ligjor” zëvendësohet me fjalën “e autorizuar” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 26

Në nenin 26, paragrafi 5, në fjalinë e fundit pas fjalës “publikimit” shtohen fjalët “në tabelën e shpalljeve” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 27

Neni 28 riformulohet si vijon:

Neni 28

Afatet

Përveç nëse është përcaktuar shprehimisht ndryshe, afatet e përcaktuara në këtë ligj llogariten sipas dispozitave përkatëse për afatet në Ligjin për Procedurën Kontestimore.

Amendamenti 28

Në nenin 32, nënparagrafi 3.1 në rreshtin e tretë, fjala “ligjor” zëvendësohet me fjalën “e autorizuar” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 32, nënparagrafi 3.2 në rreshtin e tretë, fjala “ligjor” fshihet dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 29

Në nenin 33, paragrafi 1 në rreshtin e tretë, fjala “ligjor” zëvendësohet me fjalën “të autorizuar” dhe teksti vazhdon si në projektligj. Kurse në rreshtin e tetë fjala “regjistër-mbajtësi” zëvendësohet me fjalën “zyrtari për menaxhimin e lëndëve” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 33, paragrafi 2, fjala “regjistër-mbajtësi” zëvendësohet me fjalën “zyrtari për menaxhimin e lëndëve” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 33, nënparagrafi 4.3, fjalët “Nëse dispozitat e këtij paragrafi 4” zëvendësohen me fjalët “Nëse dispozitat e paragrafit 4 të këtij neni” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 30

Në nenin 34, paragrafi 4, riformulohet si vijon: “4. Palët mund ta zgjidhin kontestin ndërmjet tyre me anë të pajtimit gjyqësor përgjatë gjithë procedurës gjyqësore. Dispozitat përkatëse në lidhje me pajtimin gjyqësor në Ligjin për Procedurën Kontestimore do të zbatohen *mutatis mutandis* në procedurat para Dhomës së Posaçme.”

Amendamenti 31

Në nenin 36, pas nënparagrafit 2.5 shtohet nënparagrafi 2.6 si vijon: “2.6. është bashkëlidhur edhe një kopje e aktit juridik kundër apo ndaj të cilit është paraqitur kërkesa/ankesa.”

Amendamenti 32

Në nenin 39, fjala “kundërkërkesë” në të gjithë tekstin e nenit zëvendësohet me fjalën “kundërpadi” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 33

Neni 40 riformulohet si vijon:

Neni 40

Përfundimi i procedurave me shkrim

1. Procedurat me shkrim do të përfundojnë:

- 1.1. Nëse pala kundërshtare nuk ka paraqitur brenda afatit ligjor përgjigjen në padi;
- 1.2. Nëse pala kundërshtare brenda afatit ligjor ka paraqitur përgjigjen në padi, por atëherë kur lejohet siç është përcaktuar në nenin 38 këtij ligji, paditësi nuk ka paraqitur brenda afatit ligjor përgjigjen ndaj përgjigjes në padi;
- 1.3. Nëse paditësi ka paraqitur brenda afatit ligjor përgjigjen ndaj përgjigjes në padi, mirëpo i padituri nuk ka dorëzuar brenda afatit ligjor kundërpërgjigjen, nëse kjo e fundit lejohet sipas nenit 38 të këtij ligji.

Amendamenti 34

Neni 43, paragrafi 6, riformulohet si vijon: “6. Në rast se një dëshmitar nuk respekton urdhrin e gjykatës, gjyqtari i lëndës, gjegjësisht kryesuesi i kolegjit, i shqipton një gjobë dëshmitarit në fjalë. Dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore në lidhje me mosrespektimin e gjykatës do të zbatohen *mutatis mutandis* në rastet përkatëse para Dhomës së Posaçme.”

Amendamenti 35

Në nenin 47, paragrafi 1, pas fjalës “ Zyrën e Regjistrimit që” shtohen fjalët “ të kërkojë nga pala që të” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 36

Në nenin 49, fjalët “shikimi i terrenit dhe inspektimi i objekteve” në të gjithë tekstin e nenit zëvendësohen me fjalët “dalja në terren dhe këqyrja në vend” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 37

Në nenin 53, paragrafi 2, fjala “të saj” zëvendësohet me fjalën “tij” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 53, paragrafi 7, riformulohet si në vijim: “7. Zyrtari përkatës për mbështetje juridike kujdeset që të mbahet procesverbali i të gjitha seancave. Ky procesverbal nënshkruhet nga palët ndërgjyqëse dhe nga gjyqtari i vetëm, gjegjësisht nga kryesuesi i kolegjit përkatës.”

Amendamenti 38

Në nenin 54, paragrafi 6, pas fjalëve “formës së prerë” shtohen fjalët “i Kolegjit të Apelit” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 54, paragrafi 7, fshihet.

Amendamenti 39

Neni 55 riformulohet si vijon:

Neni 55 Korrigjimi i aktgjykimit

Në rast të gabimeve në emra dhe numra, si dhe gabimet tjera në shkrim dhe llogaritje, mungesat në aspektin e formës së aktgjykimit dhe mospajtimi i kopjes me origjinalin e aktgjykimit, Dhoma e Posaçme, me nismë të saj apo me kërkesë të paraqitur nga palët, korrigjon aktgjykimin në çdo kohë. Në rast të korrigjimit të aktgjykimit, gjyqtari i vetëm, gjegjësisht kolegjii, zbaton *mutatis mutandis* dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Amendamenti 40

Në nenin 57, fjala “Regjistër mbajtësi” zëvendësohet me fjalët “zyrtari për menaxhimin e lëndëve” dhe fjala “plaët” në fund të fjalisë zëvendësohet me fjalën “palët”.

Amendamenti 41

Në nenin 58, paragrafi 1, fshihen fjalët “, të cilës i është dorëzuar kërkesa, nuk e parashtron përgjigjen në padi në mënyrën e duhur brenda afatit kohor të përcaktuar në mbështetje të nenit 37 të këtij ligji, ose nëse pala kundërshtare” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 42

Në nenin 59, paragrafi 6, në fund të fjalisë pas fjalës “ankesë” shtohen fjalët “te Kolegji i Apelit”.

Amendamenti 43

Neni 61 riformulohet si vijon:

Neni 61

Masat e sigurimit

1. Pas parashtrimit të propozimit nga njëra palë, Dhoma e Posaçme mund të caktojë një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi jep prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i “pariparueshëm” vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Propozimi për caktimin e masës së sigurimit duhet dorëzuar së bashku me kërkesën, ose nëse dorëzohet pas parashtrimit të një kërkesë/padie, atëherë ajo duhet t’i referohet asaj kërkesë/padie.

2. Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë një vendim lidhur me propozimin për caktimin e masës e sigurimit pa mbajtjen e seancës dëgjimore dhe pasi që pala tjetër të ketë pasur mundësinë për të paraqitur argumentet kundërshtuese me shkrim. Kur ekzistojnë rrethana urgjente që detyrojnë Dhomën e Posaçme të veprojë menjëherë lidhur me propozimin, atëherë Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë një vendim për propozimin për caktimin e masës së sigurimit pa ia dorëzuar propozimin palës tjetër. Masa e sigurimit caktohet vetëm për një periudhë kohore të caktuar dhe mund të zgjatet pas parashtrimit të kërkesës.

3. Vendimi për caktimin e masës së sigurisë bëhet me shkrim dhe do të:

3.1 përmbledhë prapavijën faktike dhe procedurale të procedurës, për aq sa ato kanë të bëjnë me masën e sigurimit;

3.2 konstatojë natyrën e dëmit që do ta pësojë pala parashtruese në rast se nuk caktohet masa e sigurimit dhe arsyet se përse Dhoma e Posaçme ka konstatuar që dëmi i tillë është i pariparueshëm;

3.3 përfshijë gjetjet e Dhomës së Posaçme mbi faktet dhe arsyetimin ligjor për miratimin e propozimit për caktimin e masës së sigurisë; si dhe

3.4 të saktësojë kohën se kur skadon masa e sigurimit.

4. Para caktimit të masës së sigurimit, Dhoma e Posaçme mund t'i kërkojë parashtruesit të depozitojë garanci financiare në Dhomën e Posaçme në shumën që Dhoma e Posaçme e konsideron se është të mjaftueshme për kompensimin e shpenzimeve dhe dëmeve që mund t'i pësojë apo mund t'i shkaktohen cilëndo palë që i nënshtrohet masës së sigurimit e që më pas konstatohet se gabimisht i është nënshtuar masës së sigurimit.

5. Vendimi për caktimin e masës së sigurimit është i detyrueshëm për të gjitha palët dhe kundër tij mund të dorëzohet ankesë menjëherë te Kolegji i Apelit.

Amendamenti 44

Në nenin 63, paragrafi 1 në rreshtin e dytë, fjala “e arsyeshme” fshihet dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 45

Në nenin 64, paragrafi 2, fjala “Rregullorja” zëvendësohet me fjalën “Rregullat” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 46

Në nenin 66, paragrafi 1, fjalët “Njoftimi për ankesë” zëvendësohen me fjalën “Ankesa” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 47

Në nenin 67, paragrafi 1, fjala “njëzetë e një (21)” zëvendësohet me fjalën “pesëmbëdhjetë (15)” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 67, paragrafi 2, fjala “e tillë” zëvendësohet me fjalët “ndaj ankesës” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 48

Neni 68 riformulohet si vijon:

Neni 68

Përfundimi i procedurave me shkrim pas ankesës

1. Procedurat me shkrim pas ankesës përfundojnë:

1.1. Nëse nuk dorëzohet brenda afatit ligjor një përgjigje në ankesë;

1.2. Nëse është dorëzuar brenda afatit ligjor një përgjigje në ankesë, por ankuesi nuk ka dorëzuar brenda afatit ligjor çfarëdo përgjigje ndaj saj, në ato raste kur është e mundur sipas nenit 38 paragrafi 3 i këtij ligji;

1.3. Pasi të ketë kaluar afati ligjor në ato raste kur dorëzimi i një kundërpërgjigje është i zbatueshëm sipas nenit 38, paragrafi 3 i këtij ligjit.

Amendamenti 49

Neni 69 paragrafi 1 riformulohet si vijon:

”1.Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë një apo më shumë seanca dëgjimore lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkesë për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.”

Amendamenti 50

Neni 71 i projektligjit fshihet dhe renditja e neneve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 51

Në nenin 73, paragrafi 7, riformulohet si vijon: “7. Pala e pakënaqur me listën përfundimtare, pavarësisht nëse është ankuar ndaj listën preliminare apo jo, ka të drejtë të dorëzojë ankesën me shkrim pranë Dhomës së Posaçme para skadimit të afatit kohor prej 20 (njëzet) ditësh dhe ankesa do të:” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 73, paragrafi 14, fjala “apelet” zëvendësohet me fjalën “ankesat” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 52

Në nenin 76 fjala “tejet” fshihet dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 53

Në nenin 77, paragrafi 1, pas fjalës “këtij” në fjalinë e parë, shtohet fjala “ligji” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 54

Neni 78 nënparagrafi 1.1 në rreshtin e njëmbëdhjetë fjala “i duhur” hiqet dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 55

Në nenin 79 fjala “ditët” zëvendësohet me fjalën “ditë”.